

AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË
“**Bio energji**” SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “**Bio energji**” SH.P.K. themelohet nga Ortaku:
Z. Llesh Taçi, shtetas shqiptar, lindur më 05.10.1958, ne Gramez, Shqiperi dhe banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me Nr. F81005043A, leshuar me date 27.01.2021 dhe e vlefshme deri me 26.01.2031 me zotesi te plote per te vepruar;

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “**Bio energji**” SH.P.K.

Neni 3
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Kavajes, Qendra tregtare “CONDOR”, Kati dyte, zyra nr.66, Tirane.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7
Emblema. Vula

7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime alternative si biogjeneratorët, fotovoltaike, parqet e ertes, termocentralet, biomasa etj. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve të energjise elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjise elektrike si dielli, era, uji, gjenrektorët magnetike si dhe i veprave të tyre ndihmese. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjise elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjise jashtë vendit. Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mesipër. Për arritjen e qëllimit të mesipër, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstatione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime germimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Neni 9

Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njëqind mijë ALL).

9.2 Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë.

9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaku i vetëm.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatëse.

10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Neni 11

Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakut te vetem te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakut te vetem raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e ortakut të vetëm

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakut te vetem.

13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakut te vetem përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.
- Vendimarrjen për investime të reja në fushën e pasurive të paluajtshme brenda apo jashtë territorit shqiptar.

Neni 14

Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

14.3 Administratori i shoqërisë është Z. Llesh Taçi, shtetas shqiptar, lindur më 05.10.1958, në Gramez, Shqiperi dhe banues në Tiranë, Shqiperi, mbajtes i letërnjoftimit me Nr. F81005043A, lëshuar me datë 27.01.2021 dhe e vlefshme deri më 26.01.2031 me zotësi të plote për të vepruar;

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.

- Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashtë saj tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
 - Të hape dege ose zyre përfaqësimi, që konsiderohen të nevojshëm për biznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese së Ortakut të vetem.

Neni 15

Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përrupthet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i vetem dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese së Ortakut të vetem.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likujdimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese së Ortakut të vetem.

18.2 Me vendimin e Asamblese së Ortakut të vetem caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.

18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Ortakut të vetem do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 08.09.2025

ORTAKU:
Z. Llesh Taçi,
Perfaqesuar me Prokurë te Posacme
Nga
Znj.Enika Hajdari

